

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Eficiencë të Energjisë nr. 06/L -079, dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, sipas shkresës së Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar-GIZ, të datës 26.01.2020,
Duke i'u referuar shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

I.

Ekspertëve të angazhuar nga Agjencioni Kosovar për Energji të Ripërtëritshme dhe Eficiencë të Energjisë – AKEREE u lejoheq qasje në projektet e Komunën së Podujevës, të përzgjedhura nga Grupi punues për aplikim në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, dhe atë:

1. Projekti për renovimin e objektit të SHFMU “ Shaban Shala”
2. Projekti i ndriçimit publik në rr.” Hakif Zejnullahu’

II.

Qasja e ekspertëve lejoheq me qëllim të incizimit të gjendjes për hartimin e projektit inxhinierik dhe auditimin energjetik.

III.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

U dërgohet:
DSHPMSH
GIZ-it; AKEREE
Arkiv

Nr.02-312/01-0017168/20
Podujevë, 04 mars 2020

Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenet 16 dhe 61 para. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, në pajtim me nenin 30.4 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mbështetur në Njoftimin e Ministrisë së Administratës Publike me nr. prot.34 (02/ZSP/06), datë 10.01.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE-QPS

Neni 1

z. Naim Potoku, zyrtar për shërbime sociale në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - Qendra për Punë Sociale, caktohet;

Ushtrues i detyrës së drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi caktohet ushtrues i detyrës deri në rekrutimin Drejtorit të QPS-së sipas procedurës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Udhëheqësi i Personelit në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale


Zyrës së Personelit

Të caktuarit

Arkivit

Nr. 02-020/02-0019255/20

Podujevë, 11 mars 2020



**Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 16 dhe 61 të statutit të komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, duke u bazuar në masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarra më 11.03.2020 për parandalimin e përhapjes së Coronavirusit COVID-19, Sipas Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, nxjerr;

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VEPRIME DHE MASA KUNDËR VIRUSIT EPIDEMIK COVID19

Neni 1

Formohet komisioni i veçantë ad-hoc për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave preventive në funksion të parandalimit të përhapjes së virusit epidemik COVID-19, në territorin e Komunës së Podujevës, në përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| 1. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, | kryesues, |
| 2. Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, | anëtar |
| 3. Fahri Llugaliu, U.D. drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF, | anëtar |
| 4. Bedrie Rama, epidemiologe, në Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, | anëtare |
| 5. Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, | anëtar |
| 6. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, | anëtar |
| 7. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, | anëtar |
| 8. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë - Podujevë, | anëtar |
| 9. Mensur Hoti, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame – Podujevë, | anëtar |
| 10. Donjeta Sheqiri, kryetare e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal – Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni ndërmerr veprime dhe masa e nevojshme në përputhje me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në përputhje me Udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë lidhur me masat preventive për parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19, si dhe veprime dhe masa tjera varësisht situatave eventuale të krijuara.

Neni 3

Vendimi hyn ditën e nënshkrimit, dhe me të njëjtin njoftohen anëtarët dhe gjithë mekanizmat relevant të nivelit qendror dhe lokal.

Nr.02-020/04-0019708/20
Podujevë,
13 mars 2020

Nënkrjetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 16 dhe 19 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, , Vendimin e QRK për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID -19 dhe Vendimin e QRK nr. prot 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, sipas Shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, nga takimi i Ekzekutivit të Komunës të mbajtur më 16.03.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

I. Për të gjitha subjektet afariste ushqimore dhe tregtarët tjerë të kësaj lëmie që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, caktohet orari i punës, dhe atë

Nga ora **08:00 – 20:00**

- a) Ofrimi i shërbimit të konsumatorëve bëhet duke respektuar rregullat dhe masat e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me theks (hyrja dhe qëndrimi i konsumatorëve në lokale afariste me rastin e furnizimit me produkte ushqimore të reduktohet në masë, sa më shumë që jetë e mundur).
- b) Për operim në ditën e diel vlejné dispozitat e Rregullores komunale për orarin e punës së bizneseve në Komunën e Podujevës

II. Obligohen Drejtorët e Drejtorive të bëjnë reduktimet në veprimet esenciale dhe staf esencial në kuadër të Administratës së Komunës, përveç personelit shëndetësor dhe inspektoratit komunal, si masë preventive ndaj infeksionit Corona virus COVID-19.

- a) Zyrtarët komunal që lirohen sipas këtij vendimi obligohen që në raste të domosdoshme, varësisht situatës së krijuar të paraqiten në vendin e punës.

- b) Orari i punës i Administratës së Komunës reduktohet dhe do të jetë nga ora **08:00- 13:00**.

III. Për zbatimin/implementimin e këtij vendimi kujdesen Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Zyra e personelit.


IV. Vendimi merret në pajtim me Vendimet e Republikës së Qeverisë së Kosovës lidhur me pandeminë e shkaktuar nga Corona virusi COVID-19, dhe i njëjti mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër.

V. Mosrespektimi i këtij vendimi do të konsiderohet si shkelje e dispozitave ligjore dhe vendimeve përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe do të merren masa ndëshkuese nga organet kompetente .

VI. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe ka fuqi juridike deri në një vendim tjetër.

Nr. 02-016/01-0019816/20

Podujevë, 16 mars 2020



Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja g) dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 19 paragrafi 1.11 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe Planin e Reagimit Kombëtar (kapitulli III Rolet dhe Përgjegjësitë) 2010, sipas Shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Lejohen mjete financiare në shumë 10,000 €, për ofrimin e ndihmave me pako ushqimore familjeve në nevojë në Komunën e Podujevës.

Mbështetja bëhet për shkak të situatës emergjente të krijuar nga pandemia COVID-19, si ndihmë për familjet në nevojë.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Sigurimi i pakove ushqimore bëhet përmes procedurave të prokurimit, ndërsa shpërndarja e tyre sipas listës së përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

- Arkivit

Nr.02-400/03-0019977/20
Podujevë, 24 mars 2020



Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari